



PARIMET E PËRBASHKËTA PËR QEVERISJEN/MBIKRQYRJEN E MEDIEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Duke pranuar rëndësinë e Medieve të Shërbimit Publik (MSHP) për shoqëritë demokratike, pluralizmin, lirinë e shprehjes, dialogun publik dhe zgjedhjet e lira dhe të ndershme;

Duke nënvizuar rëndësinë e Medieve të Shërbimit Publik (MSHP) ë pavarura që të kenë lirinë të shërbejnë si roje në shoqëri dhe që të kontrollojnë pa presion dhe frikësim;

Duke njohur rëndësinë e qeverisjes / sistemeve mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik të cilat përfaqësojnë shoqërinë në tërësinë dhe diversitetin e saj;

Duke pranuar rëndësinë e autonomisë së qeverisjes/mbikëqyrjes të Medieve të Shërbimit Publik nga ana e atyre që janë në pushtet;

Duke njohur rëndësinë dhe nevojën për depolitizim të procedurave të emërimit dhe vendosjen e rregullave të qarta të konfliktit të interesit për anëtarët e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik;

Duke pasur parasysh rëndësinë e qeverisjes/mbikëqyrjes profesionale dhe të përgjegjshme për Mediet e Shërbimit Publik, duke punuar në interes të shoqërisë dhe duke mos marrë udhëzime nga palët e treta;

Duke pasur parasysh rëndësinë e proceseve transparente dhe të hapura për zgjedhjen e organeve drejtuese, bazuar në një konsensus të gjerë;

Duke pasur parasysh rëndësinë e një ndarje të qartë të kompetencave ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe menaxheriale;

Duke pasur parasysh rëndësinë, si një garanci të pavarësisë institucionale, Mediet e Shërbimit Publik të jenë në gjendje të emërojnë dhe shkarkojnë personelin, të menaxhojnë, të kontrollojnë me kujdes operacionet e tyre, të operojnë buxhetin e tyre dhe të disponojnë me pasuritë dhe burimet e tyre siç i gjykojnë këto organizata;



Duke njohur rëndësinë e funksionimit të një politike të pavarur editoriale në mënyrë që të prodhojë, modifikojë, autorizojë, përvetësojë, promovojë dhe transmetojë përmbajtje që është në interes të publikut;

Duke pasur parasysh rëndësinë e llogaridhënies ndaj shoqërisë në lidhje me performancën e përgjegjësi të Medieve të Shërbimit Publik dhe shpenzimin e parasë publike;

Duke pranuar rëndësinë e zhvillimit të Medieve të Shërbimit Publik si një institucion thelbësor demokratik që duhet të jetë në gjendje të jetë në hap me zhvillimet teknologjike dhe dixhitale si dhe të mbetet i rëndësishëm për individët dhe shoqërinë në përgjithësi;

Përfaqësuesit e parlamenteve, organeve rregullatore, shoqërive civile dhe Medieve të Shërbimit Publik në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë , Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi rekomandojnë parimet e mëposhtme të përbashkëta për qeverisjen e Medieve të Shërbimit Publik në Ballkanin Perëndimor;

Qeverisja / mbikëqyrja e Medieve të Shërbimit Publik duhet:

1. Të përfaqësojnë dhe ti shërbejnë interesit publik;
2. Të jenë të pavarur nga fuqitë politike dhe ekonomike;
3. Të jenë të depolitizuar dhe të respektojnë rregullat e konfliktit të interesit, të cilat duhet të përcaktohen qartë;
4. Të ndjekin një proces të hapur, transparent për zgjedhjet;
5. Të jenë profesional;
6. Të jenë transparent
7. Të jenë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës;
8. Të sigurojnë një ndarje të qartë të pushteteve midis organeve mbikëqyrëse dhe menaxheriale
9. Të shmangin ndërhyrjet në menaxhimin e Medieve të Shërbimit Publik;
10. Të respektojnë dhe mbrojnë misionin që kanë dhe kornizën ligjore dhe financiare të tyre;
11. Të promovojnë rëndësinë e rolit dhe përgjegjësi të Medieve të Shërbimit Publik në shoqëri;



Në shërbim të të gjitha segmenteve të shoqërisë

1. Anëtarët e organeve menaxhuese/mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të përfaqësojnë segmente të ndryshme të shoqërisë;
2. Anëtarët e organeve qeverisëse/mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të punojnë në interes të shoqërisë;
3. Shoqëria civile duhet të jetë aktive dhe e besueshme, me një histori të pastër dhe që shtrihet disa vjet më parë, duke treguar se ata janë të pavarur nga forcat politike;

Pavarësia

1. Anëtarët e organeve qeverisëse/mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të jenë të pavarura në punën e tyre dhe të mos marrin udhëzime nga palët e jashtme, përfshirë ata që i kanë nominuar ata;
2. Kornizat ligjore duhet të sigurojnë masa të mjaftueshme mbrojtëse për pavarësinë e organeve mbikëqyrëse;
3. Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me organet qeverisëse/mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të kenë përparësi mbi dispozitat e ligjeve të tjera që nuk përputhen me pavarësinë institucionale të tyre;
4. Çështjet e lidhura me programin Medieve të Shërbimit Publik duhet të përjashtohen nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik;
5. Ligjet që rregullojnë Mediet e Shërbimit Publik duhet të zbatohen në tërësi ndërsa aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të tyre duhet të respektojnë dhe avancojnë qëllimet e këtyre ligjeve;
6. Ndryshimet ligjore në qeverisjen /mbikëqyrjen e Medieve të Shërbimit Publik duhet të miratohen vetëm pas një analize të plotë dhe një debati të gjerë publik dhe nuk duhet të përdoren për shkarkime të motivuara politikisht ose për të detyruar rreshtimin politik të organeve qeverisëse / mbikëqyrëse të MSHP;
7. Vazhdimësia e punës të organeve qeverisëse / mbikëqyrëse aktuale të Medieve të Shërbimit Publik duhet të sigurohet derisa të krijohen organet e reja;



8. Mandatet e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse të MSHP nuk duhet të ndërpriten sa herë që ndodhin ndryshime në parlament dhe qeveri;
9. Detyrat e Medieve të Shërbimit Publik dhe fondet e saj nuk duhet të përcaktohen në kontratat me qeverinë në mënyrë që të shmangët ndikimi i panevojshëm politik;
10. Punonjësit e Medieve të Shërbimit Publik duhet të përjashtohen nga korniza e përgjithshme që rregullon nëpunësit civilë, veçanërisht në vendet ku ata kanë një status të ngjashëm;
11. Organet drejtuese/mbikëqyrëse nuk duhet të përfshihen në aktivitete editoriale;

De-politizimi dhe rregulla të qarta për shmangien e konfliktit të interesit

1. Anëtarët e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik nuk duhet të mbajnë ndonjë funksion politik dhe nuk duhet të kenë mbajtur funksione të tilla për një periudhë të caktuar para emërimit të tyre;
2. Anëtarët e organeve qeverisëse /mbikëqyrëse të MSHP nuk duhet të angazhohen me biznese ose ndonjë fushë që do të përbënte konflikt interesi në lidhje me punën e tyre me MSHP.
3. Rregullat e konfliktit të interesit gjithashtu duhet të adresojnë lidhjet familjare në një mënyrë të duhur.

Procese të hapura dhe transparente për emërimet, bazuar në një konsensus të gjerë

1. Anëtarët e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të zgjidhen përmes një procesi të hapur, transparent;
2. Emërimet dhe shkarkimet e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse të MSHP duhet të bazohen në një konsensus të gjerë politik, i cili mund të arrihet për shembull duke futur kërkesën e dy të tretave të shumicës në rastet kur anëtarët zgjidhen nga parlamenti;
3. Vendimet e emërimeve dhe shkarkimeve duhet të publikohen me arsyetim dhe të jenë të hapura për rishikim gjyqësor;



Profesionalizmi

1. Kriteret për anëtarët e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të sigurojnë emërimin e profesionistëve me cilësi të lartë me përvojë disa vjeçare në fushat përkatëse të Medieve të Shërbimit Publik;
2. Organet qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të veprojnë në interes të shoqërisë dhe kur është e nevojshme mund të mbështeten në ekspertizë të jashtme ose të krijojnë organe këshilluese;
3. Nëse krijohen, organet e tilla këshilluese duhet të kenë mandate, detyra dhe përgjegjësi të qarta që nuk duhet të cenojnë kompetencat e organeve menaxheriale dhe / ose mbikëqyrëse.

Transparenca

1. Organet qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të jenë transparente në punën dhe vendimmarrjen e tyre;
2. Takimet e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse të MSHP duhet të jenë të hapura si rregull, përveç nëse vendoset ndryshe për shqyrtimin e çështjeve të veçanta;
3. Agjenda dhe raportet e takimeve të organeve drejtuese të Medieve të Shërbimit Publik duhet të publikohen dhe të gjenden lehtësisht në faqen e internetit të Medieve të Shërbimit Publik;
4. Organet qeverisëse / mbikëqyrëse të MSHP duhet të sigurojnë që Mediet e Shërbimit Publik të funksionojnë në mënyrë transparente dhe të paraqiten në mënyrë transparente në internet;

Përgjegjësia

1. Organet qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të kryejnë detyrat me kujdes të veçantë dhe të mbajnë përgjegjësi sidomos sa herë që ata marrin vendime të rëndësishme për emërimet / shkarkimet e menaxhmentit të Medieve të Shërbimit Publik dhe për çështjet financiare dhe strategjike;
2. Organet drejtuese/mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik janë përgjegjëse për miratimin ose aprovimin e strategjive, planeve dhe raporteve, të cilat janë të rëndësishme për funksionimin e tyre. Në rast



refuzimi, organet drejtuese / mbikëqyrëse të MSHP-së duhet të japin arsytetime dhe shpjegime të qarta, dhe menaxhmenti të përmirësoj strategjitë, planet dhe raportet me shkrim në mënyrë që ato të miratohen më pas.

3. Organet drejtuese / mbikëqyrëse duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e menaxhmentit të lartë në takimet e tyre

4. Nëse anëtarët e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse nuk kryejnë detyrat e tyre, ata duhet të mbajnë përgjegjësi për humbjen ose dëmin që rezulton.

Ndarja e qartë e kompetencave ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe menaxheriale

1. Organet qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik duhet të miratojnë përparësitë strategjike, të kontrollojnë mënyrën e përmbushjes së detyrave dhe të zgjedhin menaxhmentin e lartë

2. Menaxhmenti i lartë duhet të jetë i ngarkuar me operacionet e përditshme dhe të ketë përgjegjësinë përfundimtare për programimin dhe veprimtaritë operacionale

3. Menaxhmenti i Medieve të Shërbimit Publik duhet të raportojë në mënyrë periodike tek organi mbikëqyrës por ky i fundit nuk duhet të ndërhyjë në punën e përditshme të menaxhmentit

4. Organet qeverisëse / mbikëqyrëse të Medieve të Shërbimit Publik nuk duhet të minohen nga mekanizmat paralelë ose të mbivendosur të llogaridhënies

Mbroni misionin e MSHP dhe kornizën e tij ligjore dhe financiare

1. Detyra kryesore e organeve qeverisëse / mbikëqyrëse duhet të jetë mbrojtja dhe sigurimi i pavarësisë së Medieve të Shërbimit Publik

2. Organet qeverisëse / mbikëqyrëse të MSHP-së duhet të nxisin angazhim të gjerë me audiencën, të organizojnë debate rreth misionit, rolit dhe financimit të Medieve të Shërbimit Publik dhe të promovojnë konceptin e MSHP-së

Shënim: Parimet e mësipërme të përbashkëta për qeverisjen e Medieve të Shërbimit Publik në Ballkanin Perëndimor u dakorduan dhe miratuan nga palët kryesore të interesit që përfaqësojnë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në takimin rajonal të "Qeverisjes së Medieve të Shërbimit Publik " të mbajtur në Beograd më 28-29 janar 2020. Pjesëmarrësit gjithashtu shprehën vullneti i tyre për të promovuar dhe ndjekur zbatimet e parimeve të lartpërmendura.